

KORRIGJIM GABIMI

Në vendimin e Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit nr. 3, datë 4.8.2017, “Për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 159, datë 17.8.2017, faqe 7409, bëhet korrigjimi i vendimit si më poshtë:

Pika 3 e kreut 1, “Përkufizime”

Ishte:

“3. “Të ardhura bruto” nënkupton të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit të deklaruar në pasqyrën financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të përdoruesit. Nuk përfshihen në të ardhurat bruto:

a) Të ardhura nga investimet, qiratë apo aktivitete të tjera që nuk kanë lidhje me aktivitetin kryesor për të cilin është licencuar subjekti përdorues i veprës së mbrojtur.

b) Në rastin e transmetimeve radiotelevizive:

i) Shumat e arkëtuara për prodhimin e një programi radioteleviziv të porositur nga një person fizik apo juridik dhe që në fund bëhet pronë e tij;

ii) Rimarrjen e çdo shume të paguar për të marrë të drejtat ekskluzive kombëtare ose lokale të transmetimit të një ngjarjeje sportive, nëse stacioni radioteleviziv mund të vërtetojë se ka paguar edhe tarifat normale për kohën dhe pajisjet e stacionit.”.

Bëhet:

“3. “Të ardhura bruto” nënkupton të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit të deklaruar në pasqyrën financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të përdoruesit. Nuk përfshihen në të ardhurat bruto nga veprimtaria vjetore e përdoruesit:

a) të gjitha të ardhurat që rrjedhin nga aktivitete të tjera të OSHMA-ve, si shitja e mallrave dhe e produkteve;

b) të ardhurat nga reklama për prodhime të vetë OSHMA-ve;

c) të ardhurat që sigurohen nga përdorime të veprave të mbrojtura që krijohen gjatë marrëdhënieve të punësimit;

ç) të ardhurat që krijohen nga sponsorizime, financime, kredi, grante, të lidhura dhe të ngjashme;

d) të ardhurat nga veprat për të cilat subjekti përdorues ka paguar në mënyrë direkte jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

dh) të ardhurat që krijohen nga shitja ose distribucioni i të drejtave mbi programet e veta dhe paketave me programe të vetë OSHMA-ve brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

e) të ardhurat nga investimet, projektet teknike të zhvillimit, kosto të tjera që lidhen me pagesa për licencime, si OSHMA, që nuk lidhen me përdorimin e veprës së mbrojtur nga ligji;

ë) të ardhurat që krijohen nga publikimi në mediat sociale/internet, shitja ose distribucioni i të drejtave të programeve të veta dhe paketave me programe të vetë OSHMA-ve, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

f) të ardhurat që krijohen nga përdorimi i të drejtave të autorit për të cilat subjekti përdorues hyn në marrëdhënie direkte me autorin /mbajtësin e të drejtave;

g) të ardhurat që krijohen nga blerja dhe shitja e veprave/enteve që nuk mbrohen nga ligji.”.

